

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Menaxhment Financiar
(zgjidhjet)

P7

Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data: 02.07.2016

Problemi 1

ABC Co është një ndërmarrje e listuar në bursë. Kompania është duke vlerësuar një projekt investiv për të prodhuar një produkt të ri 'K3J'. Investimi fillestar është €1,800,000 dhe duhet të paguhet në fillim të vitit të parë të aktiviteteve operative. Vlerësimi fillestar është përgatitur nga një punonjës jo i kualifikuar.

Viti	1	2	3	4
Shitjet (njësitë/viti)	95,000	100,000	150,000	150,000
Çmimi i shitjes (€/njësi)	25	25	26	27
Kostot variabile (€/njësi)	11	12	12	13
<i>(Shënim: çmimi i shitjes dhe kostot variabile për njësi të listuara më lartë nuk janë korrigjuara për inflacionin)</i>				
	€000	€000	€000	€000
Të hyrat	2,475	2,605	4,064	4,220
Kostot variabile	(1,097)	(1,260)	(1,890)	(2,048)
Kostot fikse	(155)	(155)	(155)	(155)
Pagesat e interesit	(150)	(150)	(150)	(150)
Rrjedha e parasë para tatimit	1,073	1,040	1,869	1,867
Zhverësimi i lejuar përë qëllime tatimore	(450)	(450)	(450)	(450)
Fitimi i tatueshëm	623	590	1,419	1,417
Tatimi		(137)	(130)	(312)
Neto rrjedha e parasë	623	453	1,289	1,105
Norma skontuese 12%	0.893	0.797	0.712	0.636
Vlerat e tanishme	556	361	918	703
	€000			
VT e rrjedhjeve hyrëse të parasë	2,538			
Kosto e investimit	(1,800)			
VTN (NPV)	738			

Informatat e listuara më poshtë u janë vënë në dispozicion:

- Kostot relevante fikse të parashikuara janë €150,000 në vit.
- Sasia e shitjes dhe prodhimit janë të njëjta dhe nuk ka stoqe të mbajtura.
- Norma e tatimit në fitim është 22% në vit dhe paguhet një vit me vonesë.
- Lejimet e zhvlerësimit për qëllime tatimore janë 25% në vit sipas metodës së balancës zbritëse bazuar në investimin fillestar.
- Një shifër balancuese e zhvlerësimit mund të zbatohet (lejohej) në vitin e katërt.
- Pritet që inflacioni i çmimit të shitjes të jetë 4.2% në vit, i kostove variabile 5% në vit dhe i kostove fikse 3% në vit.
- Investimi fillestar nuk ka vlerë mbetëse.
- Investimi do të financohet pjesërisht nëpërmjet një kredie bankare prej €1,500,000 me normë 10%/vjetore.
- Kosto mesatare e ponderuar e kapitalit është 12% në vit.

Kërkohet

- (a) Rivlerësoni këtë investim kapital dhe tregoni se a është i pranueshëm. (20 pikë)
(b) Shpjegoni në hollësi së paku dy ndryshme të cilat i keni bërë gjatë zgjidhjes së kërkesës nën (a) (5 pikë)

(Totali = 25 pikë)

Zgjidhje e problemit - 1

(a)

	1	2	3	4	5
	€000	€000	€000	€000	€000
Të hyrat	2,475	2,714	4,413	4,775	
Kostot variabile	(1,097)	(1,323)	(2,084)	(2,370)	
Kostot fikse	(155)	(159)	(164)	(169)	
Rrjedha e parasë para tatimit	1,223	1,232	2,165	2,236	
Zhvlerësimi i lejuar	(450)	(338)	(253)	(759)	
Fitimi i tatueshëm	773	894	1,912	1,477	
Tatimi		(170)	(197)	(421)	(325)
Fitimi pas tatimit	773	724	1,715	1,056	(325)
Zhvlerësimi i lejuar	450	338	253	759	
Rrjedha e parasë pas tatimit	1,223	1,062	1,968	1,815	(325)
Faktori skontues 12%	0.893	0.797	0.712	0.636	0.567
Vlerat e tanishme	1,092	846	1,401	1,154	(184)
	€000				
VT e hyrjeve të parasë	4,309				
Kosto e investimit	(1,800)				
NVT/NPV	2,509				

Vlerësimi i korigjuar i projekti të propozuar për investim rezulton me NVT pozitive. Si përfundim, ky projekt duhet pranuar pasi që do të ndikoj në rritjen e pasurisë së aksionarëve.

Përlllogaritjet:

Viti	1	2	3	4
Shitjet (njësi/vit)	95,000	100,000	150,000	150,000
Çmimi (€njësi)	25	25	26	27
Inflacioni - 4.2% (€njësi)	26.05	27.14	29.42	31.83
Te hyrat (€000/ vit)	2,475	2,714	4,413	4,775
Viti	1	2	3	4
Shitjet (njësis/ vit)	95,000	100,000	150,000	150,000
Kostot variabile (€njësi)	11	12	12	13
Inflacioni - 5% (€njësi)	11.55	13.23	13.89	15.80
Kostot variabile (€000/vit)	1,097	1,323	2,084	2,370
Viti	1	2	3	4
Kostot fikse (€000/ vit)	150	150	150	150
Inflacioni - 3% (€000/ vit)	155	159	164	169
Viti	1	2	3	4
Zhvlerësimi i lejuar (€year)	450,000	337,500	253,125	759,375
Tatimi 0.22% (€vit)	99,000	74,250	55,688	167,063

(b) Këto janë ndryshimet nga vlerësimi fillestar i projektit kapital investiv:

Inflacioni

Vetëm inflacioni i një viti është aplikuar ndaj të hyrave nga shitja, kostove variabile dhe kostove fikse, në vitet 2, 3 dhe 4. Efekti i inflacionit në rrjedhën e parasë është kumulativ dhe në këtë rast inflacioni specifik është aplikuar ndaj secilit lloj të rrjedhës së parasë.

Pagesat e interesit

Këto nuk është dashur të përfshihen në vlerësimin fillestar pasi që efekti i financimit është i përfshirë në normën e skontimit (faktorin skontues). Në një kompani të madhe si ABC co, kredia e shfrytëzuar si pjesë e financimit të investimit është shumë e ultë në krahasim me financimet totale dhe nuk do të ketë efekt përfundimtar në koston mestarë të ponderuar të kapitalit (KMPK/WACC).

Zhvlerësimi për i lejuar qëllime tatimore

Në vlerësimin fillestar të projektit investiv është aplikuar një normë konstante prej 25% të vlerës së investimit. Sidoqoftë, metoda e cila është dashur të aplikohet është ajo e normës 25% në vit sipas balancës zbritëse, duke rezultuar në një zhvlerësim më të ultë në vitin 2 dhe 3, dhe një vlerë balancuese në vitin 4. Gjithashtu, edhe pse lejimi i zhvlerësimit për qëllime tatimore është zbritur për të përlogaritur fitimin e tatueshëm, ky tatim nuk është shtuar prapë për të përlogaritur rrjedhën e parasë pas tatimit.

Tatimi në fitim në vitin e 5-të

Kjo nuk është marrë parasysh fare, noshta për shkak të periudhës 4 vjeqare e cila është përdorur si bazë për vlerësim. Sidoqoftë, edhe rrjedha e parasë në vitin e 5-të duhet të merret parasysh pasi që në atë vit paraqitet një rrjedhje e parasë e cila është relevante, e cila rezulton pikërisht nga ky vendim investiv.

Problemi 2

ABC Co është duke vlerësuar një projekt investiv i cili ka një jetëgjatësi 4 vjeçare dhe e cila nuk do të përsëritet. Investimi fillestar i pagueshëm në fillim të vitit të parë të punës është €5,000,000. Vlera mbetëse e investimit është €500,000 e cila pritet të arkëtohet në fund të vitit të 4-të.

Ekziston pasiguri rreth çmimit të shitjes i cili mund ti vendoset produkteve të prodhuara nga ky investim, pasi që gjendja e ekonomisë pritet të ndryshoj. Parashikimet e mëposhtme të çmimeve janë bërë:

Gjendja e ekonomisë	Dobët	Mesatare	E fuqishme
Probabiliteti i gjendjes	35%	50%	15%
Çmimi i shitjes	€25 për njësi	€30 për njësi	€35 për njësi

Këto çmime priten të jenë subjekt i inflacionit të ardhshëm vjetor në lartësi prej 4% në vit.

Shitjet e parashikuara dhe kostot relevante:

Viti	1	2	3	4
Shitjet dhe prodhimi (njësitë)	150,000	250,000	400,000	300,000
Kostot variabile nominale (€'000)	2,385	4,200	7,080	5,730

Kostot fikse shtesë nominale të cilat do të rezultojnë nga ndërmarrja e këtij investimi janë €400,000. Një pjesë e madhe e këtyre shpenzimeve ndërlidhen me kostot e energjisë elektrike të cilat priten të rriten në të ardhmen për shkak të mungesës së furnizimit me energji elektrinë, andaj inflacioni i pritur është 10% në vit.

Investimi do të krijoj një zhvlerësim shtesë për qëllime tatimore sipas metodës lineare përgjatë jetëgjatësisë së investimit. Tatimi në fitim është 30% dhe ai paguhet në vitin kur edhe paraqitet. Për qëllime të vlerësimit të investimeve ABC Co zakonisht ka përdorur një normë skontuese nominale pas tatimit prej 11% në vit.

Kërkohet

(a) Përlllogarisni NVT-në e investimit dhe komentoni pranueshmërinë e investimit.

(20 pikë)

(b) Diskutoni në mënyrë kritike nëse analiza e sensitivitetit (ndjeshmërisë) mund të ndihmoj ndërmarrjen ABC co që të vlerëson rrezikun e projektit investiv.

(5 pikë)

(Totali = 25 pikë)

Zgjidhje e problemit - 2

(a)

Viti	1	2	3	4
	€000	€000	€000	€000
Të hyrat	4,524	7,843	13,048	10,179
Kostot variabile	(2,385)	(4,200)	(7,080)	(5,730)
Kontributi	2,139	3,643	5,968	4,449
Shpenzimet fikse	(440)	(484)	(532)	(586)
Rrjedha e parasë para tatimit	1,699	3,159	5,436	3,863
Tatimit	(510)	(948)	(1,631)	(1,159)
Përfitimet nga zhvlerësimi	338	338	338	338
Rrjedha e parasë pas tatimit	1,527	2,549	4,143	3,042
Vlera mbetëse				500
Rrjedha e parasë	1,527	2,549	4,143	3,542
Norma skontuese 11%	0.901	0.812	0.731	0.659
Vlera e tanishme	1,376	2,070	3,029	2,334
VT e rrjedhjeve hyrëse të parasë		€000		
Investimi		8,809		
		(5,000)		
NVT/NPV e pritur		3,809		

Projekti inventiv ka një NVT të pritur prej €3,809,000. Kjo është një NVT mesatare e cila do të rezultojë nga projekti. Sidoqoftë, meqenëse projekti nuk do të përsëritet më, NVT e asociuar me secilën rrethanë ekonomike të ardhshme duhet të përlllogaritet, pasi që vetëm njëra nga këto NVT pritet të ndodh. Vendimi për të pranuar këtë projekt do të bazohet nga vlerat e NVT-ve dhe rreziku i asociuar me secilin nga to.

Përlllogaritjet:

Çmimi mestar i shitjes = $(25 \times 0.35) + (30 \times 0.5) + (35 \times 0.15) = \text{€}29$ për njësi

Vitit	1	2	3	4
Çmimi me inflacion (€ për njësi)	30.16	31.37	32.62	33.93
Sasia (në/vit)	150,000	250,000	400,000	300,000
Të hyrat (€000/ vit)	4,524	7,843	13,048	10,179
Viti	1	2	3	4
KF me inflacion (€000/year)	440	484	532	586

Zhvlerësimi total i lejuar = $5,000,000 - 500,000 = \text{€}4,500,000$

Zhvlerësimi total i lejuar vjetor = $4,500,000/4 = \text{€}1,125,000$ p

Përfitimet vjetore nga zhvlerësimi i lejuar = $1,125,000 \times 0.3 = \text{€}337,500$ per year

(b)

Analiza e ndjeshmërisë vlerëson nivelin me të cilin NVT e projektit reagon ndaj ndryshimeve në variablat (ndryshoret) e projektit. Zakonisht përdoren dy metoda: një metodë përcakton përqindjen (%) e

ndryshimit në variablën e projektit e cila rezulton në NVT negative, ndërsa metoda tjetër përcakton përqindjen (%) e ndryshuar të NVT-së e cila rezulton nga një ndryshim fiks në përqindje (p.sh., 5%) në secilën variabël të projektit. Cilado metodë që aplikohet, qëllimi është të vlerësohet se ndaj cilës variabël është më i ndjeshëm NVT-ja, p.sh., ato të cilat një ndryshim i vogël në % rezulton në NVT negative.

Kur diskutohet për rrezikun në kuadër të vlerësimit të projekteve, është me rëndësi të theksohet se, ndryshe nga pasiguria, rreziku mund të kuantifikohet dhe matet. Probabilitetet e paraqitjes së rezultateve të ardhshme mund të vlerësohen, dhe mund të shfrytëzohen për të vlerësuar ndjeshmërinë e rrjedhës së ardhshme të parasë, duke kalkuluar devijimin standard. Një shembull i analizës së probabilitetit është rasti i kompanisë ABC co, dhe këto probabilitete mund të shprijnë në vlerësimin e rrezikut të projektit.

Çmimi i shitjes është variabël kritike, por analiza e ndjeshmërisë nuk do të tregoj nëse ka gjasa të ndodh ndryshimi në çmim në një të ardhme. Gjatë vlerësimit të projektit të ABC Co, probabilitetet e çmimeve të ndryshme kanë rezultuar nga analiza e probabilitetit dhe jo nga analiza e ndjeshmërisë.

Si rezultat i kësaj, analiza e ndjeshmërisë nuk do ti ndihmojë shumë kompanisë AB Co për të vlerësuar rrezikun e projektit investiv. Sidoqoftë, ofron informata të dobishme të cilat ndihmojnë menaxhmentin për të pasur një kuptueshmëri më të thellë të projektit investiv.

Problemi 3

Spitali Këlcyra ka hyrë në një partneritet me Këshilli Komunar Spille për sa i takon ofrimin të pajisjeve mjekësore për njerëzit që kanë probleme sociale dhe shëndetësore. Është themeluar një Magazinë e Përbashkët për Pajisje (MPP) (në të cilën Këlcyra është partneri kryesor), dhe e cila ofron një gamë të gjerë të pajisjeve përfshirë karrocet me rrota për invalidë.

Menaxheri i magazinës është i shqetësuar për sa i takon kërkesës në rritje për pajisje, e kombinuar kjo me mungesën e hapësirës për magazinim. Në të njëjtën kohë, pas bërjes së një krahasimi me një pikë të referimit [bençmarking] me një sipërmarrje të ngjashme të pabashkët, doli në pah se kostot e ruajtjes dhe magazinimit në MPP janë më të larta se organizatat e krahasueshme.

Është sugjeruar krijimi i një skeme pilot për të hetuar përdorimin e modelit të sasisë së porosisë ekonomike (SPE / EOQ) si një metodë e porositjes së pajisjeve për vitin e ardhshëm në mënyrë që të mund të adresohen çështjet që kanë të bëjnë me hapësirën për magazinim dhe kostot përkatëse. Për të provuar se si do të shkojë puna, është marrë vendimi që modeli të zbatohet sa për provë për karrocet standarde me rrota për invalidë.

Të dhënat për përdorimin e karrocave të reja standarde me rrota për invalidë janë përftuar nga sistemet e kompjuterizuara të magazinimit sipas blerjeve të bëra gjatë tre viteve të kaluara.

Viti aktual	Një vit më parë	Dy vjet më parë
260	226	199

Duke u bazuar mbi të dhënat demografike supozohet se numri i karrocave të reja me rrota për invalidë që do të kërkohet të blihen vitin e ardhshëm do të rritet dy herë sa përqindja e rritjes nga viti i kaluar në vitin aktual. Koha që kalon nga dita kur jepet porosia deri kur ajo merret në dorëzim është pak a shumë 10 ditë pune për karrocet me rrota për invalidë (le të supozojmë 250 ditë pune në vit). Kostot e mbajtjes së stokeve janë llogaritur si më poshtë: € 8 për 10 karroca me rrota për invalidë, në një vit.

Secila porosi kushton € 30 (pavarësisht prej sasisë).

Kërkohet

(a) Shpjegoni çfarë synon të arrij modeli SPE / EOQ dhe cilat janë supozimet e tij kryesore.

(7 pikë)

(b) Llogaritni SPE / EOQ për porositë e karrocave me rrota për invalidë për vitin e ardhshëm për MPP dhe kostot totale që kanë të bëjnë me kostot e porositjes dhe ruajtjes së stokeve të tilla.

(6 pikë)

(c) Përshkruani të gjitha kufizimet që dalin në pah nga përdorimi i modelit SPE / EOQ në këtë rast.

(6 pikë)

(d) Në qoftë se modeli i nivelit të ri - porositjes do të vihet në përdorim vitin e ardhshëm, llogaritni se cili do të jetë nivel i ri i stokeve për karrocet me rrota për invalidë që do të duhet të porositet (le të supozojmë se nuk mbahen stoke rezervë në nivele sigurie).

(6 pikë)

(Totali = 25 pikë)

Zgjidhje e problemit - 3

(a)

Modeli i sasisë së porosisë ekonomike (SPE / EOQ) është një model i zhvilluar për të përcaktuar madhësinë optimale të porosive që do të jepen (duke u përpjekur të reduktohen kostot totale të stoqeve). Në të njëjtën kohë ai përcakton madhësinë dhe numrin e porosive që duhet të jepen, frekuencën (shpeshtësinë) e porosive dhe koston e përgjithshme të procesit të menaxhimit të stoqeve.

Supozimet kryesore janë:

- Dihet kërkesa për secilin artikull të stoqeve.
- Ka një përdorim të njëtrajtshëm [konsistent] të stoqeve gjatë gjithë periudhës, kjo do të thotë që, kemi të bëjmë me një funksion linear.
- Sasia e porositur nuk ndryshon me kalimin e kohës.
- Kostoja e porositjes për secilin zë mund të vlerësohet dhe mbetet konstante.
- Ndryshoret e tjera janë fikse dhe nuk ndryshojnë me kalimin e kohës.
- R_i - porositja e stoqeve bëhet menjëherë, sapo niveli i stoqeve arrin zeron.
- Ka vetëm dy lloje të kostove, të cilat duhet të mbahen parasysh: kostot e mbajtjes dhe kostot e porositjes.

(b)

Në këtë rast është supozuar se numri i karrocave të reja me rrota për invalidë të kërkuara gjatë vitit të ardhshëm do të rritet me një përqindje dy herë më të madhe se sa përqindja e rritjes nga viti i kaluar tek viti aktual. Rritja nga viti i kaluar në këtë vit është $(260 \div 226) - 1 = 15\%$. Në këtë mënyrë, dyfishi i nivelit të rritjes është 30%, e cila është $260 \times 1.3 = 338$ njësi.

Formula për SPE / EOQ është si më poshtë:

$$\sqrt{(2CD \div H)}$$

ku:

C është kostoja e dhënies së një porosie

D është numri i njësiave që përdoren gjatë një viti (kërkesa)

H është kostoja e mbajtjes së një njësie për një vit.

$$= \sqrt{(2 \times 30 \times 338 \div 0.8)}$$

= 159.2 të themi 160 (karroca me rrota për invalidë) ose = 159.2 të themi 159 (karroca me rrota për invalidë)

Numri i porosive të kërkuara është $338 \div 160 = 2.11$ në vit (*kjo mund të rrumbullakohet në 2 porosi ose deri në 3 porosi ndërsa ka ndikim mbi llogaritjet e mëpasme*)

ose

Numri i porosive të kërkuara është $338 \div 159 = 2.12$ në vit (*kjo mund të rrumbullakohet në 2 porosi ose deri në 3 porosi ndërsa ka ndikim mbi llogaritjet e mëpasme*)

Kostot e porositjes = $€30 \times 2.11 = €63.30$ 1 pikë

Kostot e mbajtjes së stoqeve = $160 \div 2 \times €0.80 = €64$ 2 pikë

Kostoja totale vjetore = €63.30 + €64 = €127.30 *1 pikë*

(c)

Një nga problemet me modelin SPE / EOQ është që ai supozon se kërkesa për artikujt e stoqeve është konstante. Nuk e dimë nëse kjo është e vërtetë në këtë rast.

Në të njëjtën kohë modeli supozon se stoqet mund të bien në nivelin zero pa pasur ndikime negative për organizatën, gjë që nuk ka edhe shumë gjasa të jetë e vërtetë në këtë rast.

Gjithashtu modeli supozon se nuk do të ketë vonesa midis kohës kur jepet porosia dhe kohës kur ajo merret në dorëzim. Ky supozim nuk është fare pranë realitetit.

Disa nga karrocet me rrota për invalidë mund të përdoren përkohësisht, të kthehen në magazinë dhe të përdoren përsëri nga dikush tjetër. Llogaritjet e kostove të mbajtjes së stoqeve nuk e mbajnë parasysh këtë element.

(d)

Niveli i ri - porositjes (NRP / ROL) = Koha që kalon derisa të merret në dorëzim porosia x Kërkesa për njësi kohe

$$= 10 \times 338 \div 250 = 13.52 \text{ karroca me rrota për invalidë}$$

Diçka e tillë nënkupton se sapo niveli i stoqeve bie në 14 karroca me rrota për invalidë do të duhet të jepet një porosi e re.

Problemi 4

Ne Mësojmë Botën është biznes i cili ka për synim të ofrojë ndihmë didaktike dhe trajnime dhe të mbështesë arsimimin dhe edukimin në vendet e botës së tretë. Puna e saj përfshin në vetvete ndërtimin e shkollave dhe klasave, dhe trajnimin e mësuesve si edhe ofrimin e librave dhe materialeve të tjera didaktike. Puna në përgjithësi është vetëm me Projekte dhe kjo bën që shpenzimet të mos kenë karakteristika konsistente. Të ardhurat vijnë nga disa lloje të burimeve. Disa prej tyre bazohen mbi donacione të planifikuara nga mbështetësit (donatorët) por në të njëjtën kohë ka edhe të ardhura nga investimet e bëra nga fondacionet ose nga investimi i tepricave të parave të gatshme. Përveç kësaj, shumë e shumë përpjekje i kushtohen krijimit të marrëdhënieve të sponsorizimit me korporatat - mbështetja e të cilave për momentin megjithëse është shumë e rëndësishme, në të njëjtën kohë është edhe krejtësisht e pa - parashikueshme. Së fundi, të ardhurat gjithashtu përftohen nëpërmjet ngjarjeve speciale për përfitim të fondeve të cilat organizohen gjatë periudhave të veçanta të vitit. Rrjedhjet e të ardhurave janë të shëndetshme por të vështira për t'u parashikuar.

Dy vjet më parë një nga anëtarët e bordit ofroi shërbime këshillimi pa pagesë për menaxhmentin e firmes. Kjo bëri që të adoptoheshin disa lloje të reja të sistemeve dhe procedurave. Një nga këto ishte prezantimi i një sistemi të menaxhimit të parasë së gatshme i cili bazohej mbi modelin Baumol. Për fat të keq sistemi nuk ka qenë aq i suksesshëm sa shpresohet. Shumë shpesh tepricat e mbetura të parasë së gatshme perceptohej se ishin shumë të larta dhe herë të tjera shumë të ulëta.

Bordi ka vendosur që teprica e parasë së gatshme nuk duhet të lejohet të bjerë nën € 10,000 në të ardhmen. Është bërë një sugjerim që modeli Miller - Orr do të mund të përdoret për menaxhimin e parave të gatshme dhe për këtë arsye janë përpiluar disa të dhëna, duke u bazuar mbi arkëtimet dhe pagesat e dy viteve të kaluara. Devijimi standard i rrjedhjeve ditore neto të parave të gatshme është llogaritur si € 350. Kostoja e transferimit të fondeve (nga para e gatshme në investime ose e anasjellta) është € 70. Në qoftë se suficiti i të ardhurave investohet me disa menaxherë të investimeve, do të mund të arrihet një normë e kthimit prej mesatarisht 9% në vit.

Kërkohet

(a) Shpjegoni shkurt synimet kryesore të modelit Baumol për menaxhimin e parave të gatshme dhe synimet kryesore të modelit Miller - Orr.

(4 pikë)

(b) Shpjegoni se pse Modeli Baumol është i papërshtatshëm për 'Ne Mësojmë Botën'. Pse mund të jetë më i përshtatshëm Modeli Miller - Orr dhe në ç' mënyrë duhet të përdoret ai ?

(4 pikë)

(c) Zbatoni modelin Miller - Orr për të llogaritur tepricën e synuar të parave të gatshme, kufirin e sipërm [maksimal] dhe tepricën mesatare të vlerësuar për organizatën 'Ne Mësojmë Botën'. Duke përdorur shifrat e llogaritura shpjegoni se çfarë do të duhet të bëjë organizata

në rastet kur teprica e parasë së gatshme arrin kufirin e sipërm [maksimal] dhe të poshtëm [minimal].

(10 pikë)

(d) Identifikoni arsyet se pse është e nevojshme që organizatat të menaxhojnë paranë e tyre të gatshme.

(2 pikë)

(d) Ekzistojnë disa lloje të faktorëve që duhet të mbahen parasysh nga një organizatë në kohën kur ajo zgjedh metodat e duhura të pagesave. Identifikoni katër metodat e zakonshme të cilat mund të përdoren për të bërë pagesa në një organizatë. Për dy nga metodat e pagesës që keni identifikuar, shpjegoni faktorët që duhet të merren në konsideratë në kohën kur zgjidhen metodat në fjalë.

(5 pikë)

(Totali = 25 pikë)

Zgjidhje e problemit - 5

Zgjidhje e problemit – 5

(a)

Synimi kryesor i modelit Baumol të menaxhimit të parasë së gatshme është të identifikojnë madhësinë e hyrjeve të parasë së gatshme e cila do të minimizojë koston e kombinuar të mbajtjes dhe injektimit të parave të gatshme.

Synimi kryesor i modelit Miller – Orr është të realizohen kursime të kostove nëpërmjet përdorimit optimal të investimeve.

(b)

Modeli Baumol përmban në vetvete disa supozime të cilat janë të papërshatshme për organizatën 'Ne Mësojmë Botën':

- Rrjedhjet e parave të gatshme janë të përcaktuara dhe konstante. Nuk ndodh fare kështu në rastin e Ne Mësojmë Botën për shkak se disa prej hyrjeve të të ardhurave janë të pa -parashikueshme.
- Hyrjet e ardhurave janë të rregullta dhe periodike. Përsëri, edhe kjo nuk është e saktë. Ne Mësojmë Botën mund të përftojë hyrjet jashtëzakonisht të mëdha parave të gatshme herë pas here.
- Modeli supozon se nuk ekzistojnë kosto në qoftë se organizata mbetet pa para të gatshme dhe nuk parashikon ndonjë mbitërheqje bankare. Ndonjëherë tepricat mund të mbeten aq të ulëta sa do të ishte e rrezikshme për çdo organizatë.

Modeli Miller-Orr përfshin disa karakteristika të cilat mund të jenë më të dobishme:

- Ai lejon që rrjedhjet neto të parasë së gatshme, të ndodhin sipas karakteristikave të çfarëdoshme;
- Modeli mund të trajtojë shumat e mëdha ose të vogla monetare bashkë me parregullsitë e rrjedhjeve të parave të gatshme;
- Është shumë më pranë realitetit dhe ofron një bazë të mirë për kontrollimin e mënyrës së menaxhimit të parasë së gatshme;
- Ndryshimet mund të jenë të rastësishme dhe të paparashikueshme;
- Modeli në fjalë i kapërcen supozimet e thjeshtëzuara të qënies konstante dhe sigurisë së kërkesës që përmban Modeli Baumol

Ky model, zgjeron edhe më tej modelin e kontrollit të menaxhmentit, duke vënë në funksion disa kufij të zakonshëm të kontrolleve: modeli krijon kufij të sipërm dhe të poshtëm të kontrollit, brenda të cilëve lejohet të luhatet teprica ditore e parasë së gatshme. Në qoftë se teprica ditore e parasë së gatshme arrin kufirin e sipërm të kontrollit, duhet që paraja e gatshme të përdoret për të blerë letra të tregtueshme me vlerë. Shuma monetare që do të përdoret për të blerë letra të tregtueshme me vlerë përcaktohet si diferenca midis kufirit të sipërm të kontrollit dhe nivelit të synuar të parasë së gatshme. E anasjellta, në kohën kur arrihet kufiri i ulët [minimal], kërkohet një futje e parave të gatshme, e cila e kthen tepricën në nivelin e synuar.

(c)

Formulat për llogaritjen e tepricës së synuar Z, kufirit të sipërm [maksimal] H dhe tepricës mesatare VV janë:

$$Z = \sqrt[3]{\frac{3F\sigma^2}{4K}} + L$$

$$H = 3Z - 2L$$

$$VV = (4Z - L) / 3$$

Ku:

F = kostoja e transaksionit

K = kostoja ditore oportune e tepricave të parave të gatshme

σ^2 = varianca e rrjedhjeve ditore neto të parasë së gatshme (σ = devijimi ose shmangia standarde).

$$K = \sqrt[365]{(1+R)} - 1 \text{ ku } R \text{ është norma, dhe } D \text{ është numri i ditëve (365)}$$

$$K = \sqrt[365]{(1+0.09)} - 1 = 1.000236131 - 1 = 0.000236131$$

Interesi i thjeshtë mund të përdoret duke u bazuar mbi $0.09 \div 365 = 0.000247$. Kjo është e pranueshme por duhet të jepet vetëm 1 pikë

$$\begin{aligned} \sigma^2 &\text{ është varianca dhe është llogaritur duke përdorur devijimin standard} \\ &= 350^2 = 122,500 \end{aligned}$$

$$Z = \sqrt[3]{\frac{3F\sigma^2}{4K}} + L = 3\sqrt{[(3 \times 70 \times 122,500) \div (4 \times 0.000236131)]}$$

$$= 3\sqrt{[(25,725,000) \div (0.000944524)]} + 10,000$$

$$= 3\sqrt{(27,235,941,070)} + 10,000 = 3,009 + 10,000 = 13,009$$

$$H = 3Z - 2L$$

$$= (3 \times 13,009) - (2 \times 10,000) = \text{€}19,027$$

$$VV = (4Z - L) \div 3$$

$$= (4 \times 13,009 - 10,000) \div 3$$

$$= \text{€}14,012$$

Shpjegimi i plotë duhet të jetë:

- Në kohën kur teprica bie në € 10,000 do të duhet të tërhiqet nga investimet një shumë monetare prej €3,009 për të ri – krijuar tepricën e synuar (diferenca midis tepricës së synuar prej €13,009 dhe kufirit të ulët [minimal] prej €10,000).
- Në kohën kur teprica rritet dhe arrin €19,027 do të duhet të investohet një shumë monetare prej €6,018 (diferenca midis kufirit të sipërm prej €19,027 dhe tepricës së synuar prej €13,009).

(d)

Organizatat kanë nevojë që të menaxhojnë paratë e gatshme për arsye të mëposhtme:

- Bërja e sigurt se ka para të mjaftueshme të gatshme për të përmbushur kërkesat afat - shkurtra operacionale;
- Bërja e sigurt se ka para të mjaftueshme të gatshme për të përmbushur kërkesat për shpenzime kapitale;

Bërja e sigurt se ka para të mjaftueshme të gatshme për të përmbushur kërkesat themelore që nuk ishin parashikuar (të papritura);

- Identifikimi i të gjitha suficiteve ose deficiteve të parasë së gatshme dhe planifikimi i duhur për t'i trajtuar ato me efikasitet dhe efektivitet;
- Identifikimi dhe menaxhimi i aktiviteteve që influencojnë pozicionin e parasë së gatshme (të tilla si pagesat e llogarive të pagueshme dhe mbledhja e borxheve ose e llogarive të arkëtueshme).

(e)

Metodat më të zakonshme të kryerjes së pagesave dhe përfundimit të arkëtimit janë:

- Me anë të parave të gatshme.
- Me anë të çeqeve.
- Me anë të kartave të debitit dhe të kreditit.
- Me anë të debitimeve dhe të kreditimeve direkte.
- Me anë të SVVIFT

Faktorët të cilët influencojnë zgjedhjen e metodës së pagesës janë:

- Siguria
- Kostot
- Thjeshtësia
- Siguria
- Vonesat

Studentët duhet të zgjedhin 2 nga metodat e pagesës që kanë identifikuar dhe shpjegojnë mënyrën se si mund të zbatohen faktorët më sipër ndaj secilës metode.